



## “Gjerësia e Hauzit tim është sa një muaj ecje. Uji i tij është më i bardhë se qumështi, aroma e tij është më e mirë se myshku

Abdullah ibën Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë:  
“Gjerësia e Hauzit tim është sa një muaj ecje. Uji i tij është më i bardhë se qumështi, aroma e tij është më e mirë se myshku, enët e tij janë sikurse yjet e qiellit. Kush pi prej tij, nuk do të ketë etje kurrë.”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ në këtë hadith tregon se ai do të ketë Hauz (Pellg) në Ditën e Kiametit, gjatësia dhe gjerësia e të cilit do të jetë sa një muaj ecje. Uji i tij është më i bardhë se qumështi, aroma e tij është e pastër dhe më e këndshme se aroma e myshkut, enët e tij janë sikurse yjet në qiell, pra, aq shumë. Kush pi prej Hauzit me këto enë, nuk do të ketë etje kurrë.

<https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/65030>

